



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT

Nr. 99 Prot.

Tiranë, më 6 / 1 / 2019

**Lënda:** Informimi i konsumatorit për ushqimet një komponent i rëndësishëm i përcaktimit të sigurisë ushqimore.

**Drejtuar:** Zt. Luan Bregasi, President i Biznes Albania

*I Nderuar Zoti Bregasi,*

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), në kuadër të përpjekjeve për rritjen e sigurisë ushqimore në vend, krahas të tjerave i ka kushtuar një rëndësi të posaçme sensibilizimit të subjekteve dhe të konsumatorëve.

Kështu gjatë vitit 2018 veç publikimeve në website, e mediatizimeve të proceseve, pjesëmarrje në panairë, apo takimeve të drejtpërdrejta me grupe biznesesh sipas sektorëve, kemi patur komunikim të drejtpërdrejtë shkresor me qindra subjekte (gjithsej 5029 subjekteve)<sup>1</sup> përmes të cilave në kuadër edhe të transparencës i kemi informuar

- Çfarë verifikon në vend AKU në kuadër të kontrollit zyrtar
- Sqarime rreth list verifikimit që u është dërguar bashkëlidhur
- Kërkesat për sistemin e gjurmueshmërisë
- Kërkesat ligjore për sigurinë e materialeve në kontakt me ushqimin
- Shkeljet që kemi hasur më shpesh
- Konsekuencat ligjore në rast të shkeljeve të sigurisë ushqimore

Ndërsa duke marrë në konsideratë se<sup>2</sup>, jashtë dhe pavarësisht masave të marra nga AKU, sukcesi dhe efica në rritjen e garantimit të sigurisë ushqimore kërkon si domosdoshmëri edhe angazhimin e konsumatorëve (!), kemi qenë interaktiv me publikun e mediat për t'iu përgjigjur kërkesave dhe ankesave, si dhe kemi filluar një plan ambicioz në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore për trajnime ndërgjegjësuere për sigurinë ushqimore me nxënësit e shkollave<sup>3</sup>, për ta shtrirë me tej edhe me grupe të tjera konsumatorësh.

<sup>1</sup> Konkretisht u jemi drejtuar me shkresa të personalizuara 320 stabilimenteve të qumështit, 84 fabrikave të përpunimit të vajit të ullirit, 1200 dyqaneve të tregëtimit të mishit, 40 thertoreve, 1534 subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë në zonën turistike të vendit, 1038 subjekteve supermarket e magazine ushqimore, 53 subjekteve importues të inpueteve bujqësore, 368 subjekteve të tregëtimit me shumicë dhe/ose pakicë të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve", 375 subjekteve të tregëtimit me shumicë dhe/ose pakicë të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve për hyrjen në fuqi të dy VKM-ve të reja", 77 subjekteve grumbullues e tregëtues të fruta perimeve, 24 subjekte stabilimenti përpunim peshku

<sup>2</sup> sipas vlerësimeve tona por edhe përvojës ndërkombëtare

<sup>3</sup> Synimi ynë është që ky program të fokusohet fillimisht pranë nxënësve të shkollave duke e konsideruar këtë një hap të rëndësishëm në kultivimin e qytetarëve të informuar në fushën e sigurisë ushqimore por edhe aktivë për ta promovuar atë (sigurinë ushqimore) tek familjet e tyre dhe kudo

Duke marrë në konsideratë rolin e misionin Tuaj, që veç të tjerave konsiston në shkëmbim informacioni me administratën publike dhe promovimi e realizimi i shërbimeve me interes të përgjithshëm dhe duke qenë në pamundësi objektive për t'u drejtuar personalisht secilit operator biznesi, gjykoam t'ju drejtohem me këtë letër duke kërkuar bashkëpunim për sensibilizim të subjekteve lidhur me informimin e konsumatorit për produktet që hedhin në treg, etiketimin e tij etj.

Siç dihet në neni 11/1 të Ligjit 9863 datë 28.1.2008 "Për ushqimin" i ndryshuar sanksionohet se

- Për të përcaktuar nëse një ushqim nuk është i sigurtë duhet patur parasysh: kushtet normale të përdorimit të ushqimit nga konsumatori; informacioni që i jepet konsumatorit, përfshirë informacionin e dhënë në etiketë ose informacione të tjera të vlefshme për të, për parandalimin e efekteve të dëmshme, specifike për shëndetin nga një ushqim i caktuar ose nga një kategori ushqimesh

**Paraprakisht**, shprehim vlerësime për sipërmarrjen në tërësi për përpjekjen serioze dhe arritjet e sektorit në drejtim të ofrimit të produkteve të sigurta për konsumatorët në të gjithë gjeografinë e vendit - arritje të cilat kanë ardhur në sajë të investimeve e zbatimit të standardeve bashkëkohore në këtë fushë, duke passjell si rezultat krahas sigurisë së produkteve ushqimore edhe rritje punësimi e rritje ekonomike në këtë sektor.

Rritja e mëtejshme e stadardeve të Sigurisë Ushqimore, vlerësojmë është një sfidë e përbashkët që kërkon një vlerësim dhe një impenjim maksimal nga të dy palët: biznesi e përfaqësuesit e tij nga njëra anë dhe autoriteti publik nga ana tjetër, ndër të tjera edhe përmes shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të mira në këtë drejtim, forcimit të besimit të ndërsjelltë, rritje e transparencës dhe përgjegjshmërisë me konsumatorët mbi atë që u ofrohet për konsum etj...

Përveç praktikave të mira e në përmirësim të vazhdueshëm, evidentojmë se gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese e mbikëqyrëse në jo në pak raste është konstatuar edhe fenomeni i tregtimit të produkteve ushqimore pa etiketën përkatëse, apo me etiketa të njëanshme jo në përputhje me aktet ligjore, apo dhe raste ku megjithëse etiketat janë miratuar konform ligjit, produkti i nxjerrë në treg për konsum shoqërohen me etiketa të manipuluaru përta i përket përbërësve dhe informacionit tjetër, duke i dhënë produktit cilësi/karakteristika që realisht nuk i mbart.

Çështja e etiketimit nuk është thjesht një element dekorativ/figurant që produktet ushqimore duhet ta kenë për shkaqe reklamimi, por është detyrim i kërkesave rregullatore, pasi është mënyra e vetme nëpërmjet së cilës konsumatori merr informacion lidhur me produktin që ofrohet për konsum.

Gjithashtu përbën problematikë serioze fakti se produktet ushqimore hidhen në treg në mënyrë të njëanshme – ndërkohë që nuk kanë karta teknologjike të individualizuara e deklaruar në AKU<sup>4</sup> pra produktet hidhen në treg pa asnjë informacion apo një vlerësim shkencor mbi *llojin, natyrën,*

---

<sup>4</sup> Është "CV" e produktit ushqimor, pasi përmban informacion të hollësishëm mbi përbërësit dhe sasi të nevojshme për prodhimin e këtyre produkteve, mbi procesin teknologjik të përshkruar me faza, në përfundim të cilit të mund të arrihet të krijohet një vlerësim mbi natyrën dhe karakteristikën e produktit në fjalë.

*cilësinë, riskun impaktin mbi shëndet, tipologjinë e konsumatorit apo dhe nivelin e konsumit të lejuar ditor.*

Tendenca dhe preçedenti i krijuar se pajisja e produktit me "etiketën" e miratuar nga AKU-ja, ju jep të drejtën operatorëve për hedhjen në treg të tij, është e gabuar, pasi notifikimi i etiketës është faza fundore e procesit<sup>5</sup>, por sfida dhe të dhënat e vërteta është përshkrimi i produktit nëpërmjet kartës teknologjike<sup>6</sup>.

Pra është një praktikë e gabuar mënjanimi i verifikimit të kartës teknologjike, duke u mjaftuar vetëm në shqyrtimin e aplikimit për notifikim të etiketës, pasi kjo e fundit shërben për marrjen e informacionit të nevojshëm vizual të konsumatorit gjatë ballafaqimit me produktin në treg, ndërsa karta teknologjike e produktit përbën "pasaportën e tij" që mund të vlerësohet vetëm nga autoritete të specializuara siç është AKU-ja<sup>7</sup>.

Lidhur me veprimtarinë e shqyrtimit e notifikimit të etiketave dhe veprimtarinë inspektuese në subjekte sa lidhet me respektimin e kërkesave të etiketimit si dhe Ju informojmë sa vijon:

1. Në tabelën në vijim pasqyrohet numri i subjekteve që kanë aplikuar për etiketë dhe numri total i etiketave të notifikuara në vitet 2017 e 2018

	Viti 2017	Viti 2018
Numri i kërkesave për notifikim	614	927
Numri i etiketave të aplikuara për notifikim	5613	7052
Numri i etiketave jo konforme të konstatuara gjatë shqyrtimit të aplikimit	2217	1492
Numri i etiketave konforme e të miratuara pas shqyrtimit të aplikimit	2116	3657

Sikurse shihet nga tabela gjatë vitit 2018 ka një rritje të fortë të numrit të kërkesave për notifikim të etiketave në aspekt të subjekteve që kanë aplikuar por edhe numrit të etiketave për të cilat është aplikuar.

Kjo rritje të numrit të kërkesave për notifikim të etiketave është tregues i drejtpërdrejtë i sensibilizimit të subjekteve në interes të informimit të konsumatorit (përveç presionit pozitiv e ligjor të AKU përmes inspektimeve në terren).

Nga të dhënat tabelore veç rritjes së numrit të kërkesave për notifikim, spikat edhe rritja gjatë vitit 2018 e numrit të etiketave të miratuara në raport me ato të refuzuara krahasimisht me këtë raport në 2017 – çka është tregues i rritjes së kapaciteteve të vetë subjekteve në aspekt të njohjes e zbatimit të kërkesave rregullative për etiketimin.

<sup>5</sup> Etiketimi shërben për marrjen e informacionit të nevojshëm vizual të konsumatorit gjatë ballafaqimit me produktin në treg

<sup>6</sup> karta teknologjike e produktit përbën "pasaportën e tij" që mund të vlerësohet vetëm nga autoritete të specializuara siç është AKU-ja

<sup>7</sup> Referuar neni neni 41 pika 11 të Ligjit 9863 datë 28 I 2008 "Për ushqimin" i ndryshuar sanksionohet se: Kontrolli zyrtar i ushqimeve ka objekt: Proceset teknologjike që zbatohen në prodhimin dhe përgatitjen e ushqimeve. Ndërsa referuar VKM nr 434 datë 20.5.2015: Karta teknologjike, duhet të jetë e konfirmuar certifikuar nga një institucioni njohur, që ka aftësinë teknike të konfirmimit të kartave teknologjike, si: ... Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), ...

Në këtë drejtim padyshim që AKU ka ofruar ndihmë dhe asistencë të pandërprerë. Kështu përveç arsytimit shterrues të mangësive në etiketim në rastet e refuzimit të kërkesave<sup>8</sup>, kemi pritur e sqaruar në mënyrë të drejtpërdrejtë KAQ% të aplikantëve/subjekteve kërkuar<sup>9</sup>.

2. Në tabelën në vijim pasqyrohet numri i etiketave për produkte të përbëra me produkte qumështi të notifikuara dhe atyre të revokuara për vitin 2018 dhe për krejt periudhën pararendëse

	Periudha 2009 - 2017	Viti 2018
Numri i etiketave produkt i përbërë të notifikuara nga AKU	19	39
Numri i etiketave produkti përbërë të revokuara për shkak të miratimit tyre në kundërshtim me ligjin	0	8

Sikurse shihet gjatë vitit 2018 janë miratuar/notifikuar më shumë etiketa për produkte të përbëra me produkte qumështi krahasimisht me gjithë periudhën që nga krijimi i AKU në vitin 2009.

Natyrshëm që besohet dhe është gjerësisht e pranuar (e madje edhe e konstatuar nga ana jonë) se këto produkte kanë qenë në treg por janë tregëtuar në kushte të plota paligjshmërie duke keqinformuar konsumatorin se gjoja janë gjizë, salcë kosi, gjalp apo djath kaçkavall, ndonëse në fakt nuk kanë qenë të tilla pasi në varësi të produktit ato kanë patur në përbërje % të caktuara vaj palme, amidon etj. – sikurse rast pas rasti i kanë edhe tani por që nuk emërtohen gjizë apo salcë kosi por `produkt i përbërë` me një emër të caktuar sipas kopmanisë që e prodhon dhe tregëton.

3. Në tabelën në vijim pasqyrohet numri i inspektimeve dhe masat e marra për secilin qark në vitet 2017 e 2018

Qarku	Inspektime gjithsej	Viti 2017 <sup>10</sup>				Viti 2018				
		Masa administrative për etiketimin				Masa administrative për etiketimin				
		Gjoja		Bllokim produkti (sasia)		Gjoja		Bllokim produkti (sasia)		
		Numër	Vlerë	Kg	Litra	Numër	Vlerë	Kg	Litra	
Kukës	1,229	2	100,000	13		1,165	9	450,000	140	
Korçë	2,976	11	600,000		1,381	2,081	18	1,150,000		3,465
Shkodër	2,116	6	370,000	1,527		646	22	1,250,000	8,898	
Tiranë	5,971	45	3,300,000	169		6,011	51	3,750,000	2,571	
Fier	1,370	9	600,000	9,399	20,428	919	17	950,000	1,916	
Vlorë	2,377	6	350,000	52		1,823	20	1,050,000	665	6,523
Dibër	440	0	0	0		652	7	400,000	834	
Elbasan	3,141	1	50,000	1		2,954	20	2,400,000	7,556	
Gjirokastrë	792	1	100,000		38,504	743	8	650,000		18,365
Izoh	1,420	0	0	0		1,234	11	550,000	432	
Berat	1,490	13	650,000	6,265		1,169	20	1,200,000	20,426	
Durrës	3,531	10	720,000	3,945	25	2,463	32	2,550,000	8,736	48,660

<sup>8</sup> Në rastet e refuzimit të kërkesave për notifikim, refuzimi është arsyetuar duke dhënë qartazi mangësitë sëbashku me referencat rregullative duke i dhënë mundësi të plotë subjektet të kuptojë e rikuperojë mangësitë

<sup>9</sup> Në funksion të transparencës dhe larg larg praktikave abuzive çdo takim me subjektet është dokumentuar me procesverbal takim i cili është i administruar rregullisht

<sup>10</sup> 60% e rezultateve të vitit 2017 i përkasin periudhës tetor – dhjetor 2017

Total	26,353	91	6,740,000	21,358	60,338	21,860	203	15,700,000	52,035	77,013
-------	--------	----	-----------	--------	--------	--------	-----	------------	--------	--------

Siç parashtruam, respektimi i kërkesave të etiketimit të produkteve është një detyrim ligjor dhe si i tillë siç dihet nuk ka ligj pa sanksion.

AKU i ka kushtuar vëmendje të posaçme sensibilizimit të subjekteve posaçërisht për zbatimin e kërkesave të etiketimit. Kështu veç të tjerave, bashkëlidhur kësaj shkrese ju dërgojmë një material informues që AKU ka dërguar që me 9 Nëntor 2017 një game të madhe subjektesh e organizatash përfaqësuese të tyre<sup>11</sup> me tematikë “Mbi problematikat e evidentuara gjatë procesit të vlerësimit të etiketave të produkteve ushqimor” .

Mirëpo përveç reagimit pozitiv të subjekteve në përgjithësi, janë ndeshur raste shkeljesh të cilat natyrshëm që janë ndëshkuar e do të ndëshkohen pa hezitim në çdo rast kur konstatohen nga trupat inspektuese të AKU.

**4. Në vijim të këtij qëndrimi dhe praktike të mirë që përpiqemi të krijojmë, e çmojmë me vënd të evidentojmë mangësi e të meta që kemi hasur gjatë këtij procesi, në funksion të njohjes sa më gjerë të subjekteve me qëllim parandalimin e tyre në të ardhmen.**

a. Kështu nga shqyrtimi i kërkesave për etiketim të produkteve ushqimore haset jo rrallë që Operatorët e Bizneseve Ushqimore

- nuk janë shumë të informuar lidhur me aktet ligjore për mënyrën e etiketimit,
- janë të pa informuar me ndryshimet e reja në legjislacionin ushqimor,
- modeli i etiketës në shumicën e rasteve kryet nga dizenjatorët, jo nga ekspertë të fushës të cilët e njohin legjislacionin në të cilin mbështetet etiketimi i produkteve ushqimore.

b. Më poshtë paraqesim mangësi të evidentuara më shpesh në aplikimet për notifikim etiketash:

- Deklarimi në etiketë i emrave tregtarë, marka, logo, dizenjo industriale të paregjistruara dhe mbrojtura pranë Drejtorisë së Përgjithshme Pronësisë Industriale.
- Paraqitja në etiketë e treguesve: *Produkt Tradicional, Emërtim Origjine, Tregues Gjeografik*, të cilët referuar Ligj Për Ushqimin, i ndryshuar përcaktohen me udhëzim të veçantë dhe duhet të jenë të mbrojtura që të mund të deklarohen në etiketë.
- Mosdeklarimi i përbërësve të produktit ushqimor në etiketë në rend zbritës, bazuar në përqindjen që zënë këto të fundit në produkt, si dhe mungesa e theksuar në njohjen e mënyrës së deklarimit të shtesave (aditivëve) ushqimore në listën e përbërësve.
- Vështirësi në përcaktimin e dallimit midis dy shprehjeve: “*Preferohet të përdoret përpara...*” dhe “*Përdoret deri më...*”.
- Mosdeklarimi i sasisë neto për produktet e lëngëta (njësitë e volumit) në ml, mL, cl, cL, L ose l ose për produktet e ngurta ( njësitë e masës) në g ose kg, dhe simbolet nuk duhet të ndiqen nga shënja e pikësimit pas tyre.
- Mosdeklarim i saktë i vlerave ushqimore mesatare të produktit ushqimor, si dhe deklarime të vlerave shëndetsore, të cilat nuk janë të mbështetura në evidencë shkencore të pranuar.

<sup>11</sup> Aq kontakte sa kishim

- Mosdeklarimi i emrit dhe adresës së biznesit prodhues /ambalazhues /tregëtues siç është i regjistruar në regjistrin elektronik në QKB.
- Deklarime në etiketa jo të sakta për vendndodhjen e burimit për produktin ujë mineral natyral. deklarimi i emrit tregtar paraqitet në përmasa më të mëdha se emri i burimit si dhe etiketimi me dy ose më shumë emra tregtar të të njëjtit burim.

Gjithashtu, evidentojmë se në muajin Korrik 2018 është publikuar në Fletoren Zyrtare VKM nr.434/2018<sup>12</sup> në të cilën midis shumë risive mund të përmendim *detyrimin për të paraqitur në etiketë Vlerat ushqimore mesatare për 100 g ose 100 ml produkt dhe deklarimin në listën e përbërësve të përbërësve/substancave alergente.*

*Të Nderuar,*

Siç parashtruar më lart duke marrë në konsideratë misionin Tuaj dhe rolin e pazëvendësueshëm në drejtim të lehtësimit të komunikimit me operatorët e biznesit, gjykojmë t'Ju drejtohem me këtë letër për këtë çështje kaq sensitive sikurse është informimi i publikut për produktet që hidhen në treg, por nga ana tjetër dëshirojmë dhe besojmë që të vendosim një bashkëpunim real, funksional e të pandërprerë për çdo problematikë që hasin subjektet që lidhet me veprimtarinë tonë apo për ndërmarrjen e nismave të përbashkëta në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit e rritjes së Sigurisë Ushqimore në vend.


Veç komunikimit me shkrim, sipas kohës dhe agjendës Suaj, për këto çështje e të tjera jemi disponibël për të organizuar e marrë pjesë në takime edhe me organizatën Tuaj e bizneset që përfaqësoni.

v.o. jeni të lutur që këtë shkresë informative tua përcillni në rrugë elektronike të gjithë OBU anëtarë të organizatës Suaj duke i siguruar ata se çdo paqartësi lidhur me kërkesat ligjore të etiketimit e për çdo kërkesë tjetër rregullatore, janë të mirëpritur të na kontaktojnë në rrugë elektronike në adresën [info@aku.gov.al](mailto:info@aku.gov.al) apo në zyrat e AKU çdo ditë<sup>13</sup>.

*Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,*

**DREJTORI PËRGJITHSHËM**

**Agim ISMAILI**



<sup>12</sup> "Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit", e cila hyn në fuqi pas dy vitesh pas publikimit në Fletoren Zyrtare  
<sup>13</sup> legjislacioni i plotë ushqimor gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit ([www.aku.gov.al](http://www.aku.gov.al)).